



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0005630/26 dt. 02.02.2026
Mitrovicë

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për të **martën** më dt. **10.02.2026**:

T H Ë R R E T
Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës
(Mbledhja e 4-të)

Mbledhja do të ketë këtë REND DITE:

1. Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Propozim vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve
4. Propozim vendim për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026
5. Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
6. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
7. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
8. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Zhvillim Ekonomik
9. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit
10. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
11. Propozim vendim për formimin e Komitetit për Barazi Gjinore
12. Propozim vendim për shpalljen e konkursit për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026
13. Propozim vendim Për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave
14. Propozim vendim Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM "Uniteti"
15. Propozim vendim Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Qendra Multifunkionale"
16. Propozim vendim Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"-SH.A.
17. Propozim vendim Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu"
18. Propozim vendim Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve
19. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit
Safet KAMBIRI



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 63 të Ligjit Nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c), të Ligjit Nr. 03L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, më datë 20.01.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

- I. **Z.Lavdim Zeneli**, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Mitrovicën e Jugut, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës- PDK", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal **z. Arian Tahiri**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet Lavdim Zeneli dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 19.01.2026 me numër të protokollit 07/7-88/2026, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal, i cili ka dhënë dorëheqje, për arsye personale. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është Lavdim Zeneli. Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimt të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke ruajtur kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 20.01.2026

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 63 të Ligjit Nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c), nenin 65 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, më datë 30.01.2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

- I. **Z..Bajram Istrefi**, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Mitrovica e Jugut, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal **z. Naser Muja**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet Bajram Istrefi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 28.01.2026 me numër të protokollit 07/7-136/2026, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal, i cili ka dhënë dorëheqje për arsye të emërimit në pozitën e Drejtorit Komunal. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është Bajram Istrefi. Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke ruajtur kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 30.01.2026

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0078642-2/26 dt. 11.01.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL
Nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës
Seanca e 2-të

Koha: 11.01.2026 ora 21:30

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Igballe Islami, Ferdi Kadriu, Artan Berisha, Egzon Hamza, Gëzim Stavileci, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Liridona Muharremi, Nazmije Sejdiu, Armend Begu, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Naser Muja, Rinesa Preteni, Sazan Ramaxhiku, Afërdita Hajrizi, Visar Syla, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Safet Kamberi, Oltion Ahmeti, Xhyljeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda

Kryetari i Komunës z. Faton Peci
Përfaqësues të MAPL-së
Përfaqësues të Shoqërisë Civile
Mediat

Mungoi: Arian Tahiri

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi anëtari më i vjetër në moshë i Kuvendit z. Naser Muja i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe në vazhdim theksoi se në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, të Statutit të Komunës së Mitrovicës në cilësinë anëtarit më të moshuar të Kuvendit të Komunës, me kërkesë të Kryetarit të komunës kam thirrur mbledhjen e 2-të urgjente të Kuvendit të Komunës, me këtë rend dite:

1. Dhënia e betimit nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Arian Tahiri
2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

Kryesuesi i mbledhjes theksoi, meqenëse anëtari i Kuvendit nuk është i pranishëm dhe të njëjtit i është dhënë mundësia që betimi të bëhet sot, nëse ai paraqitet para Kuvendit mund ta bëjë betimin, dhe vuri në votim rendin e ditës:

Rezultati i votimit: 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Kuvendi i Komunës unanimisht miratoi rendin e ditës.

Pika 1

Kryesuesi i mbledhjes theksoi, meqenëse anëtari i Kuvendit nuk është i pranishëm dhe të njëjtit i është dhënë mundësia që betimi të bëhet sot, nëse ai paraqitet para Kuvendit mund ta bëjë betimin.

Pika 2

Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin dhe kërkoi nga anëtarët e Kuvendit që të propozojnë kandidatët për Kryesues të Kuvendit të Komunës.

Oltion Ahmeti: Në emër të grupit parlamentar të LDK-së, propozoj z. Safet Kamberi për Kryesues të Kuvendit Komunal.

Shkëlqim Ibrahim: Nga Partia Demokratike e Kosovës nuk ka kandidat dhe kërkoj që procesi të zhvillohet në mënyrë sa më korrekte dhe të qartë.

Kryesuesi i mbledhjes kërkoj nga Kuvendi se a ka propozime respektivisht kandidat tjetër nga radhët e Kuvendit dhe pasi konstatoi se nuk ka propozime tjera, e konstatoi të përmbyllur Listën e kandidatëve për Kryesues të Kuvendit vetëm me një kandidat, **z. Safet Kamberi**.

Kryesuesi në vazhdim i propozoj Kuvendit që të formojë Komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit të fshehtë për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës edhe pasi e informoj që Kuvendi mund të përcaktohet që Komisioni t'i ketë 3 deri në 5 anëtarë, propozoj që Komisioni ti ketë 5 anëtarë dhe mori pajtimin e Kuvendit.

Kryesuesi i mbledhjes në vazhdim kërkoi nga anëtarët e Kuvendit të propozojnë kandidatët nga radhët e Kuvendit për anëtarë të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit të fshehtë për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Z. Shkëlqim Brahimi për anëtarë të Komisionit nga subjekti politik PDK propozoi z. Egzon Hamza.

Z. Kushtrim Zeneli për anëtarë të Komisionit nga subjekti politik VV propozoi znj. Sazan Ramaxhiku.

Z. Afërdita Hajrizi nga subjekti politik Guxo, për anëtarë të Komisionit propozoj z. Visar Syla

Z. Oltion Ahmeti nga subjekti politik LDK, për anëtarë të Komisionit propozoj znj. Arta Neziri.

Z. Safet Kamberi nga subjekti politik AKR, për anëtarë të Komisionit propozoj z. Gjergj Beka.

Kryesuesi vuri në votim propozimin vendimin dhe përbërjen e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit të fshehtë për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Rezultati i votimit: 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Kuvendi i Komunës miratoi unanimisht Vendimin për formimin e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit të fshehtë për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. në përbërje: Egzon Hamza, Sazan Ramaxhiku, Visar Syla, Arta Neziri dhe Gjergj Beka.

Kryesuesi i mbledhjes kërkoi nga Komisioni që të fillohet me procesin e votimit të fshehtë siç parashihet me LVL.

Anëtari i Komisionit z. Gjergj Beka shpjegoi procedurat dhe formën e votimit të fshehtë.

Kryetari i Komisionit ftoi me radhë të gjithë anëtarët e Kuvendit që të votojnë.

Pas përfundimit të votimit Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit konstatoi se në votim kanë marrë pjesë dhe kanë votuar 30 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mbledhje dhe filluan numërimin e votave.

Z. Gjergj Beka në emër të Komisionit pas numërimit të votave shpalli rezultatin e Raundit të parë të votimit si në vijim:

30 anëtarë të Kuvendit të pranishëm kanë votuar.

Rezultati i votimit: 18 për, 10 kundër dhe 2 vota të pavlefshme.

Kryesuesi i mbledhjes pas komunikimit të rezultatit të votimit të fshehtë nga kryetari i Komisionit, konstaton se:

Kuvendi i Komunës me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit me 18 vota PËR dhe 10 vota KUNDËR dhe 2 vota TË PAVLEFSHME, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut ZGJEDHET z. Safet Kamberi.

Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes pasi uroj z. Safet Kamberi për zgjedhjen Kryesues i Kuvendit të Komunës, të njëjtën e ftoi që të merr detyrën e Kryesuesit të Kuvendit dhe të vazhdojë me kryesimin e mbledhjes.

Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit: I nderuar Kryetar i Komunës z. Faton Peci, të nderuar anëtarë të Kuvendit, të nderuar përfaqësues MAPL-së, të shoqërisë civile dhe të nderuar të pranishëm në këtë mbledhje sot.

Fillimisht dua t'i falënderojë anëtarët e Kuvendit të cilët më mbështetën, për mua është nder, privilegj dhe përgjegjësi që të jem në këtë pozitë dhe zotohem para jush që me nder dhe përgjegjësi do e ushtroj funksionin e Kryesuesit të Kuvendit të Mitrovicës duke respektuar në përpikëri ligjet dhe rregulloret në fuqi, po ashtu ju garantoj se secili do ta ketë të hapësirën e diskutimit për të ngritur çështjet e tyre dhe të qytetarëve. Pra shpresoj që bashkë me ju anëtarë të Kuvendit, do të jemi në shërbim të qytetarëve të Mitrovicës dhe të ndikojnë në përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së tyre.

Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi theksoj se mbledhja e rregullt e Kuvendit do të mbahet nesër sipas agjendës që ka qenë e paraparë sepse janë dy pika mjaft me rëndësi siç është Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete që janë trupa të Kuvendit dhe janë të rëndësishme për funksionimin e Kuvendit të Komunës, atëherë për sot i mbyll punimet e mbledhjes së Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 22:30 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesi i Kuvendit

Afërdita MAXHUNI

Safet KAMBERI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0078642-1/26 dt. 12.01.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës
(mbledhja e 3-të)

Koha: 12.01.2026 ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Igballe Islami, Ferdi Kadriu, Artan Berisha, Egzon Hamza, Gëzim Stavileci, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Liridona Muharremi, Nazmije Sejdiu, Armend Begu, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Naser Muja, Rinesa Preteni, Sazan Ramaxhiku, Afërdita Hajrizi, Visar Sylja, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Safet Kamberi, Oltion Ahmeti, Xhyljeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda
Kryetari i Komunës z. Faton Peci
Përfaqësues të MAPL-së
Përfaqësues të Shoqërisë Civile
Mediat

Mungoi: Arian Tahiri

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët të Kuvendit, përfaqësuesit e Ministrisë së Pushtetit Lokal, organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, media dhe të pranishmit tjerë. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit theksoi Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, me kërkesë të Kryetarit të Komunës dhe anëtarit më të vjetër të kuvendit është thirrur mbledhja e 2-të e rregullt të Kuvendit të Komunës, meqenëse pika 2 është konsumuar në takimin urgjent të Kuvendit Komunal, kërkoj nga ju që ta miratojmë rendin e ditës pa këtë pike, me rend dite siç është paraparë me thirrje, Kryesuesi hapi diskutim.

Igballe Islami: propozoj që si pikë e rendit të ditës të futet pika, Informatë për gjendjen pas vërshimeve në Mitrovicë.

Kryesuesi i Kuvendit - Meqenëse kjo është realisht vazhdimësi e seancës urgjente të Kuvendit, pra e konstituimit të grupeve dhe trupave të Kuvendit, nuk e shoh të arsyeshme që sot të diskutohet rreth kësaj çështjeje. Nëse ka diçka shumë urgjente, mund të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme për të diskutuar rreth kësaj çështjeje, por besoj se në këtë fazë nuk mund të kontribuoj me diçka, veçanërisht duke marrë parasysh se sot realisht jemi në seancën e konstituimit të trupave të Kuvendit.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Përhëndetje për të gjithë. Unë asnjëherë, gjatë gjithë mandatit, nuk do t'i shmangem asnjë debati dhe asnjë pike diskutimi që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe mbarëvajtjen e qeverisjes komunale. Kjo mbledhje është realisht një vazhdimësi e konstituimit të mekanizmave dhe trupave që janë të domosdoshëm për funksionimin e Asamblesë. Në parim, edhe një herë po e përsëris, nuk jam kundër debatit për asnjë temë, çfarëdo qoftë ajo, por do të sugjeroja që këto tema të mos përfshihen brenda procesit të konstituimit të trupave të Kuvendit Komunal. Ne jemi të gatshëm të diskutojmë kurdo që Asambleja e vlerëson të arsyeshme por njëkohësisht duhet të kemi parasysh se vazhdojmë të jemi në gjendje emergjente, kështu që mund të diskutojmë, por ndoshta në një fazë kur vlerësojmë se kjo gjendje është tejkaluar. Gjithashtu, ne jemi të hapur të pranojmë edhe propozime, jo domosdoshmërisht vetëm përmes Asamblesë, veprojmë shpeshherë edhe mbi bazën e sugjerimeve të ekspertëve dhe të qytetarëve Kështu që, kurdo që ju vlerësoni se mund të jetë temë diskutimi dhe se mund të kontribuojë në mbarëvajtjen dhe efikasitetin sa më të madh në shërbim të qytetarëve, asnjëherë nuk do të keni refuzimin apo kundërshtimin tim. Sugjerimi im është, ashtu siç tha Kryesuesi, ta përfundojmë sot konstituimin e trupave përfaqësuese dhe prej nesër, kur të doni, të mblidhemi dhe të diskutojmë edhe për gjendjen emergjente.

Kryesuesi i Kuvendit: znj. Islami, a dëshiron të vazhdojmë më tutje apo je e interesuar ta tërheqësh propozimin dhe ta lëmë për një fazë tjetër, që konsideroj dhe jam shumë i bindur se do të ishte më e përshtatshme?

Shkëlqim Brahimi: Po, pajtohem me mendimin tuaj dhe e tërheq propozimin si pikë të rendit të ditës. Mendojmë që në seancën e radhës të trajtohet konkretisht dhe të flitet në detaje.

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim për miratim rendin e ditës si ne vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës
2. Propozim-vendim për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa
3. Propozim-vendim për formimin e Komitetit për Komunitete

Rezultati i votimit: 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Kuvendi i Komunës unanimitisht miratoi rendin e ditës.

Pika 1

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me procesverbalin nga mbledhja e parë inauguruese e kuvendit.

Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim, atëherë e hedh në votim procesverbalin nga mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit të Komunës.

Rezultati i votimit: 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se procesverbali i mbledhjes inauguruese të kuvendit u miratua unanimitisht.

Pika 2

Kryesuesi sqaroi se çështja ishte diskutuar paraprakisht në takimin me përfaqësuesit e grupeve politike të përfaqësuar në Kuvendin Komunal, ku ishte rikonfirmuar përbërja e komitetit në përputhje me dispozitat ligjore. Ai bëri të ditur se Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, me këtë përfaqësim politik: dhe ndarja do të jetë në këtë mënyrë: 7 anëtarë gjithsej: 3 do të jenë nga PDK-ja; 2 nga LVV-ja dhe 1 nga Guxo, duke përfshirë edhe pozitën e Kryesuesit të komitetit, i cili është përfaqësues politik nga radhët e LDK-së.

Në vazhdim, kryesuesi informoi se sa i përket Komitetit për Komunitete, është arritur pajtueshmëri që të vazhdohet me përbërjen prej 11 (njëmbëdhjetë) anëtarësh, ku do të jenë të përfaqësuar të gjitha partitë politike që janë pjesë e Kuvendit Komunal: PDK, Lëvizja Vetëvendosje GUXO dhe LDK si dhe hapësirë për partitë e tjera të përfaqësuar në Kuvend (AKR, NISMA dhe Forca e Diasporës), përfshirë edhe përfaqësues nga komunitetet që jetojnë në

Komunën e Mitrovicës. Kryesuesi theksoi se kjo përbën një pajtueshmëri të arritur ndërmjet përfaqësuesve të partive politike. Më tej, kryesuesi theksoi se gjatë propozimit të anëtarëve të KPF-së duhet të respektohet edhe përfaqësimi gjinor, ashtu siç parashihet me ligj. U theksua se ishte arritur dakordim që PDK-ja të përfaqësohet me 2+1 anëtarë në favor të gjinisë femërore, Lëvizja Vetëvendosje me 1+1 anëtarë, ndërsa GUXO me 1 anëtar. Kryesuesi hapi diskutimin dhe ftoi grupin më të madh parlamentar, PDK-në, që të paraqesë propozimet e saj.

Në vazhdim Kryesuesi kërkoi nga subjektet politike të propozojnë anëtarët e tyre për anëtarë të KPF-së.

Shkëlqim Ibrahim: Nga radhët e PDK-së, për anëtarë të KPF-së propozoj znj. Igballe Islami, znj. Majlinda Kurti dhe z.Valon Brahimi.

Kushtrim Zeneli: Nga radhët e LVV-së, për anëtarë të KPF-së propozoj znj. Erseka Barani, dhe z. Kushtrim Zeneli.

Xhevdet Osmani: Nga radhët e GUXO-së, për anëtarë të KPF-së propozoj z.Valon Syla.

Kryesuesi i Kuvendit meqenëse nuk ka propozime tjera, konstatoi se në seancë janë të pranishëm 30 anëtarë të Kuvendit, atëherë hedh në votim Propozim-vendimin për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në përbërje si në vijim:

1. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit, nga subjekti politik LDK,
2. Majlinda Kurti - nga subjekti politik PDK,
3. Igballe Islami - nga subjekti politik PDK,
4. Valon Brahimi - nga subjekti politik PDK,
5. Erseka Barani - nga subjekti politik LVV,
6. Kushtrim Zeneli - nga subjekti politik LVV, dhe
7. Visar Syla - nga subjekti politik Guxo.

Rezultati i votimit: 30 për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika 3

Kryesuesi i Kuvendit sqaroi se përbërja e këtij komiteti do të jetë me 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, prej të cilëve 6 (gjashtë) anëtarë nga Kuvendi Komunal dhe 5 (pesë) anëtarë nga komunitetet. Në vazhdim, kryesuesi kërkoi propozimet nga komunitetet. Gjatë diskutimit u ngritën shqetësime dhe problematika lidhur me përfaqësimin gjinor. Kryesuesi theksoi se diskutimi për përfaqësimin gjinor është i drejtë dhe i nevojshëm, pasi gjatë këtij procesi janë hasur vështirësi reale në sigurimin e përfaqësimit të barabartë gjinor. Ai theksoi se kjo çështje nuk është vetëm vendim i Kuvendit, por kërkon koordinim dhe dakordim mes grupeve politike. Kryesuesi deklaroi se, meqenëse janë duke u diskutuar edhe alternativa të tjera për përfaqësimin gjinor në Komitetin për Komunitete, dhe për shkak të kompleksitetit të situatës, kërkoi pauzë prej 15 minutash për t'u konsultuar me shefat e grupeve parlamentare.

Pauzë 15 minuta.

Pas pauzës, Kryesuesi sqaroi se konsultimet kishin të bënin ekskluzivisht me përfaqësimin gjinor, pasi ligji kërkon që në një komitet prej 11 anëtarësh të ketë minimumi 5 anëtarë nga njëra gjini. U theksua se, në këtë rast, për shkak të përbërjes ekzistuese, është e domosdoshme që ky kusht të përmbushet për të qenë vendimi në harmoni me ligjin. Kryesuesi deklaroi se, megjithë vështirësitë, ishte arritur dakordim që në përbërjen e Komitetit për Komunitete të jenë të përfaqësuara të gjitha partitë politike në Kuvendin Komunal, përfshirë subjektet: PDK, Vetëvendosje, LDK, AKR, NISMA dhe Forca e Diasporës, u sqarua gjithashtu se ekziston dakordim ndërmjet NISMËS dhe GUXO-s për mënyrën e përfaqësimit në këtë komitet, dhe se përbërja përfshin edhe 5 anëtarë nga komunitetet që jetojnë në Komunën e Mitrovicës. Kryesuesi kërkoi miratim në parim për strukturën e komitetit (6 nga Kuvendi dhe 5 nga komunitetet). Pas hedhjes në votim, u konstatua se struktura e Komitetit për Komunitete u miratua me votë

unanime. Kryesuesi theksoi se tash duhet të vazhdohet me koordinim ndërmjet partive politike për emrat konkretë, duke pranuar se procesi është i vështirë dhe kërkon mirëkuptim. Ai falënderoi kryesuesit e grupeve për qasjen konstruktive, duke theksuar se jo gjithmonë vullneti politik mund të përmbushet për shkak të rrethanave objektive.

Në vazhdim Kryesuesi kërkoi nga subjektet politike që të propozojnë anëtarët e tyre për në KPK.

Shkëlqim Ibrahim: PDK-ja propozon z.Fisnik Suma.

Kushtrim Zeneli: LVV-ja propozon z. Armend Begu.

Xhevdet Osmani : GUXO propozon z. Flamur Vojvoda.

Kryesuesi Safet Kamberi: LDK-ja propozon z.Oltion Ahmeti.

Kryesuesi Safet Kamberi: Nga radhët e AKR-së propozoj z.Gjergj Beka dhe nga Forca e Diasporës z. Jeton Ujkani.

Në vazhdim Kryesuesi nga Komunitetet kryetari i komunës propozon: nga Komuniteti turk z. Fitim Terziqi, nga Komuniteti Boshnjak znj. Dzenita Sabani, nga Komuniteti Egjiptian znj. Sibela Fetahu, nga Komuniteti Ashkali znj. Hamide Hyseni dhe nga Komuniteti Rom znj. Sadete Gashiani.

Xhyljeta Imeri: LDK-ja propozon znj. Xhyljeta Imeri.

Kryesuesi atëherë meqenëse i kemi dy propozime nga LDK-ja do ti votojmë së pari këto dy propozime nga GP i LDK-së ndaras sipas alfabetit dhe pastaj të gjitha propozimet bashkërisht.

Kryesuesi vuri në votim propozimin që z.Oltion Ahmeti nga radhët e LDK-së të jetë anëtarë i KPK.

Rezultati i votimit: 13 për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi vuri në votim propozimin që znj. Xhyljeta Imeri nga radhët e LDK-së të jetë anëtare e KPK.

Rezultati i votimit: 26 për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi thekson se si rezultat i votimit, znj.Xhyljeta Imeri mbetet propozimi zyrtar i LDK-së për Komitetin për Komunitete

Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin për formimin e Komitetit për Komunitete në përbërje:

1. Fisnik Suma - nga subjekti politik PDK,
2. Armend Begu - nga subjekti politik LVV,
3. Xhyljeta Imeri - nga subjekti politik LDK,
4. Flamur Vojvoda - nga subjekti politik NISMA,
5. Gjergj Beka - nga subjekti politik AKR,
6. Jeton Ujkani - nga subjekti politik FeD,
7. Fitim Terziqi - nga komuniteti turk,
8. Dzenita Sabani - nga komuniteti boshnjak,
9. Sibela Fetahu - nga komuniteti egjiptian,
10. Hamide Hyseni - nga komuniteti ashkali, dhe
11. Sadete Gashiani - nga komuniteti rom.

Rezultati i votimit: 27-për, 3-kundër, 0-abstenime.

Kryesuesi i kuvendit konstatoi të miratuar Vendimin për formimin e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit mbyllë punimet e mbledhjes në ora 11:38 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesi i Kuvendit

Afërdita MAXHUNI

Safet KAMBERI



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	30.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0004429-1/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.01.2026, pasi shqyrtoi Propozim vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve, sjellë këtë:

Konkluzion

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Propozim vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve.
2. Propozim vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

SHTOJCË: *Propozim vendimi për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve*



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATË/A:	26.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-000929-7/1/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	PROPOZIM-VENDIM Për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2026

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale, dhe nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 4, dhe nenit 52, paragrafi 2, të Statutit të Komunës, Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

Propozim-vendim

Për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2026

1. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës mbahen të mërkurën e javës së fundit të muajit, duke filluar nga ora 10:00.
2. Mbledhjet e rregullta të Komitetit për Politikë dhe Financa mbahen së paku dy (2) javë para mbledhjes së Kuvendit të Komunës, respektivisht ditën e mërkurë.
3. Kryesuesi i Kuvendit, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, sipas nevojës mund të thërras mbledhje të rregullta edhe jashtë orarit të përcaktuar me pikën 1 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	30.01.2026
REFERENCE:	Nr. 02-060/01-0004429-2/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim vendim për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.01.2026, pasi shqyrtoi Propozim vendimin për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026, sjellë këtë:

Konkluzion

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Propozim vendimin për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026.
2. Propozim vendimi për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026 i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

SHTOJCË: *Propozim vendimi për formimin e Grupit Punues Për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2026*



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATE/A:	26.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-004429-2/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	PROPOZIM-VENDIM Për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale, dhe nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 4, dhe nenit 52, paragrafi 2, të Statutit të Komunës, Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

Propozim-vendim

Për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026

1. Me këtë propozim-vendim propozohet të FORMOHET Grupi Punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026, në përbërje prej _____ anëtarëve.
2. Detyrë e Grupit Punues të formuar me pikën 1 të këtij vendimi është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës me dispozita të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe dispozitave të ligjeve tjera, pjesën me kompetenca të komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë Planin vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2026. Pas hartimit të planit të punës, të njëjtin do t'ia procedojë Kuvendit të Komunës për miratim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Grupi Punues i formuar me këtë vendim.
4. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	30.01.2026
REFERENCE:	Nr. 02-060/01-0004429-3/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.01.2026, pasi shqyrtoi Propozim vendimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, sjellë këtë:

Konkluzion

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Propozim vendimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
2. Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

SHTOJCË: *Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi*



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	20.01.2026
REFERENCE:	Nr. 02-060/01-0004429-3/26
PËR/ZA/TO:	Z Safet Kamberi- Kryesues i Kuvendit të Komunës
CC:	Kuvendin e Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Faton Peci- Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim Vendim Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika d, dhe 58 pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale, në nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe 77 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 7 të Ligjit Nr. 04/-L-076 Për policinë; dhe në bazë të nenit 3, të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

1. Me këtë propozim vendim propozohet të **THEMELOHET** Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.
2. KKSBJ-ja është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve të komune dhe përfaqësues të shoqërisë civile
3. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi do të ketë këtë përbërje:
 - 2.1 Kryetari i Komunës (Kryesues);
 - 2.2 Komandanti i Stacionit të Policisë;
 - 2.3 Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës.
 - 2.4 Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të komunës;
 - 2.5 Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës;
 - 2.6 Zyrtari për Barazi Gjinore;
 - 2.7 Drejtori i Drejtorisë për Arsim;
 - 2.8 Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Komunës;
 - 2.9 Një përfaqësues i FSK-së;
 - 2.10 Një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike;
 - 2.11 Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;
 - 2.12 Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale;
 - 2.13 Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim;
 - 2.14 Një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e KKSB-së janë:
 - 3.1 Përgatitja e Planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi.
 - 3.2 Identifikimi i dukurive negative, që tentojnë të prishin sigurinë publike dhe rekomandojnë planet e veprimit.
 - 3.3 Bashkëpunimi me policinë për parandalimin e veprimeve, të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi.
 - 3.4 Bashkëpunimi me institucionet qendrore, që merren me sigurinë publike me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi.
 - 3.5 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi, që i tejkalojnë kufijtë e Komunës së tyre.
 - 3.6 Të kërkojë nga Kuvendi i Komunës financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë.
 - 3.7 Përmes Komunës të kërkojë nga ndonjë organizatë joqeveritare financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë.
 - 3.8 Fton në takimet e tyre përfaqësuesit e MPB-së DSB.
 - 3.9 Fton përfaqësues nga institucionet qeveritare të mediave ose përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që të marrin pjesë në takimet e KKSB-së.
 - 3.10 Kërkon nga policia përgjigje për rastet, që janë me rëndësi për sigurinë e bashkësisë duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore.
 - 3.11 Mbajtja e takimeve të rregullta ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të këtij Udhëzimi Administrativ.
5. Kryesues i KSSB-së është Kryetari i Komunës dhe në mungesë të tij takimin e KSSB-së e kryeson Zëvendëskryetari me të drejta dhe përgjegjësi të plota ashtu siç i ka Kryesuesi i KKSB-së.
6. Në themelimin e KKSB-së merren parasysh kriteret e përfaqësimit gjinor dhe nevojën e përfaqësimit të drejtë të të gjitha bashkësive fetare.
7. Funkzioni i KKSB-së detyrat dhe përgjegjësitë e kryesuesit të KKSB-së përfaqësimi i Komuniteteve në KKSB, mbledhjet e KKSB-së, pjesëmarrja në mbledhje, vendimmarrja zëvendësimi i anëtarëve të KKBS-së, dorëheqja bashkëpunimi, raportimi, mbikëqyrja etj., rregullohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL.
8. Sugjerimet dhe rekomandimet e KKSB-së mund të merren si rekomandime për veprime të institucioneve përkatëse.
9. Anëtarët e KSSB-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.
10. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
11. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	30.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0004429-4/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim vendim për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.01.2026, pasi shqyrtoi Propozim vendimin për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, sjellë këtë:

Konkluzion

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Propozim vendimin për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Propozim vendimi për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

SHTOJCË: *Propozim vendimi për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale*



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South
KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATË/A:	26.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0004429-4/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
CC:	Faton Peci – Kryetar i Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim vendim Për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; neneve: 61, paragrafi 2, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 13, paragrafët: 1 dhe 3, si dhe nenit 14, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme në komunë dhe komiteve tjera; Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

Propozim-vendim
Për formimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

- Me këtë propozim-vendim propozohet FORMIMI i Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në përbërje prej 5 anëtarësh, 3 prej të cilëve duhet të jenë anëtarë të Kuvendit. Komiteti duhet të reflektojë përbërjen e Kuvendit të Komunës.
- Anëtarët e komiteve tjera nuk kanë të drejtë të jenë në më shumë se një komitet.
- Kompetencat dhe aktivitetet e komitetit janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale Nr. 01/2009 Për punën e komiteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:
 - Monitoron implementimin e shërbimeve për kujdesin primar shëndetësor në Komunë;
 - Shqyrton projekt-buxhetin për shëndetësi dhe jep propozime për Komitetin për Politikë dhe Financa;
 - Shqyrton planin vjetor të punës të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale;
 - Monitoron zbatimin e dispozitave në lidhje me grupet e varfra të njerëzve, invalidëve të luftës, viktimave e dhunës familjare, fëmijë të mitur, të pastrehëve, të rikthyerve dhe pensionistëve;
 - Këshillon dhe konsultohet me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Mirëqenies Sociale;
 - Ndihmon në caktimin e fondeve për strehim;
 - Harton propozimet për strategjitë strehuese me qira, duke përfshirë ndërtimin e shtëpive, dhe prioritetet kryesore përkatëse për renovime ndërtimesh dhe ndihma financiare; dhe
Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, nenit 25 dhe nenit 58 alineja h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale, nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-087 Për ndërmarrjet publike, dhe nenit 46 paragrafi 1, nënparagrafi 5, dhe nenit 77, paragrafi 1.10, të Statutit të Komunës, Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

Propozim-vendim

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve"- SH.A.

1. I propozohet Kuvendit të Komunës formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Stacioni i Autobusëve" - SH.A. në përbërje:
 1. _____ (anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës),
 2. _____ (anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës).
 3. _____ (emërohet me Vendim nga Kryetari i Komunës).
2. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.
3. Komisioni me shumicë të thjeshtë votash vendos se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.
4. Komisioni do të përgatisë dhe nxjerrë një politikë të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të Komunës në lidhje me pronësinë dhe rolin e saj në qeverisjen e NP "Stacioni i Autobusëve"- SH.A. Kjo politikë e pronësisë duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe dispozitat tjera të aplikueshme ligjore në Kosovë. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbajë dispozita të hollësishme mbi mënyrën e zbatimit të saj.
5. Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj dhe do t'i raportojë Kuvendit të Komunës në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë, si dhe do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e menaxhimit të ndërmarrjes.
6. Komisioni i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me këtë ligj.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	30.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0004429-15/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu"

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.01.2026, pasi shqyrtoi Propozim vendimin për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu", sjellë këtë:

Konkluzion

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Propozim vendimin për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu".
2. Propozim vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu" i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

SHTOJCË: *Propozim vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu"*



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	26.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0004429-15/26
PËR/ZA/TO:	Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit
CC:	Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa Anëtarët e Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Faton Peci – Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim Vendim Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu"

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, nenit 25 dhe nenit 58 alineja h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale, nenit 5, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-087 Për ndërmarrjet publike, dhe nenit 46 paragrafi 1, nënparagrafi 5, dhe nenit 77, paragrafi 1.10, të Statutit të Komunës, Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

Propozim-vendim

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu"

1. I propozohet Kuvendit të Komunës formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Tregu" në përbërje:
 1. _____ (anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës),
 2. _____ (anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës).
 3. _____ (emërohet me Vendim nga Kryetari i Komunës).
2. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.
3. Komisioni me shumicë të thjeshtë votash vendos se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.
4. Komisioni do të përgatisë dhe nxjerrë një politikë të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të Komunës në lidhje me pronësinë dhe rolin e saj në qeverisjen e NP "Tregu". Kjo politikë e pronësisë duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe dispozitat tjera të aplikueshme ligjore në Kosovë. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbajë dispozita të hollësishme mbi mënyrën e zbatimit të saj.
5. Komisioni Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj dhe do t'i raportojë Kuvendit të Komunës në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë, si dhe do t'i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e menaxhimit të ndërmarrjes.
6. Komisioni i përgjigjet Kuvendit të Komunës mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me këtë ligj.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	30.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0004429-16/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim vendim për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.01.2026, pasi shqyrtoi Propozim vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve, sjellë këtë:

Konkluzion

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Propozim vendimin për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.
2. Propozim vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

SHTOJCË: *Propozim vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve*



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	26.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0004429-16 /26
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
CC:	Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit
NGA/OD/FROM:	Faton Peci – Kryetar i Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	PROPOZIM-VENDIM Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, pika d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008); nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

Propozim-vendim

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve

1. Me këtë propozim-vendim i propozohet Kuvendit të Komunës të FORMOJË Komisionin për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve, në përbërje prej 5 anëtarëve: 3 anëtarë nga radhët e Kuvendit të Komunës dhe 2 anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës.
2. Detyrë e Komisionit të propozuar me pikën 1 të këtij propozim-vendimi është shqyrtimi dhe vendosja në lidhje me të gjitha ankesat e paraqitura në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjet Publike Lokale, si dhe ankesat e paraqitura në procedurat e përzgjedhjes së zyrtarëve të NPL-ve, të parapara me nenin 21, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-087 Për ndërmarrjet publike.
3. Komisioni i formuar për punën e tij do t'i raportojë me shkrim Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës për të gjitha çështjet e shqyrtuara.
4. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	30.01.2026
REFERENCË:	Nr. 02-060/01-0004429-18/26
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës
CC:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025

Duke u bazuar në nenin 52, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale dhe nenin 65, paragrafi 6, të Statutit të Komunës; Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.01.2026, pasi shqyrtoi Raportin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025, sjellë këtë:

Konkluzion

1. Komiteti për Politikë dhe Financa miraton Raportin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.
2. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025 i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

SHTOJCË: *Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025*



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATE/A:	26.01.2026
REFERENC-Ë:	02-060/01-0004429-18/26
PËR/ZA/TO:	Anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut
CC:	Z. Safet Kamberi – Kryesues i Kuvendit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	RAPORT I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025

Të nderuar,

Kuvendi i Komunës si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisjes lokale, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të komunës. Veprimtaria e Kuvendi i komunës së Mitrovicës së Jugut mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Kushtetuta e Kosovës, parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të cilat prekin nivelin lokal, Statutin e komunës si dhe rregulloret e miratuara nga vet Kuvendi i Komunës, si më poshtë:

- Ligjin për vetëqeverisjen lokale
- Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës
- Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal
- Ligjin për kufijtë administrativ të komunave
- Ligjin për financat e pushtetit lokal
- Ligjin për zgjedhjet lokale në republikën e Kosovës
- Ligjin për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë etj.

Raporti vjetor i punës së Kuvendit të Komunës i vitit 2025 synon të japë një panoramë analitike dhe informacionin e nevojshëm mbi aktivitetin Kuvendit dhe punën e Sekretarisë së Kuvendit në përmbushje të detyrave të këtij institucioni të rëndësishëm. Përmes këtij Raporti mundohemi t'u krijojmë informim të duhur qytetarëve lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Raporti shërben edhe si një mjet tjetër që do të rrisë transparencën në lidhje me aktivitetin e pushtetit lokal për periudhën e raportimit.

Në zbatim të përgjegjësiave të veta si organ i komunës, Kuvendi i Komunës ka marrë vendime të rëndësishme për periudhën janar - dhjetor 2025, si:

Kuvendi i Komunës ka miratuar Buxhetin për vitin 2026 në shumë prej 32,418, 756.00 €, dhe parashikimet për vitet 2027-2028.

Përmbledhje

Raporti i hartuar përmbledh të dhëna për funksionimin e Kuvendit, funksionimin e komiteteve obligative dhe funksionale, dhe komiteteve dhe trupave tjerë të Kuvendit, pasqyrën e realizimit të objektivave sipas planit, si dhe vendimmarrjen. Prezantimi i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës ka rëndësi të shumëfishtë, ngase me ligj Kuvendi i Komunës njihet organi më i lartë në strukturën organizative të Komunës dhe i ushtrojnë kompetencat vetanake dhe të deleguara në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Pasqyrimi i punës së Kuvendit përfshinë në mënyrë indirekte edhe shpalosje e punës së ekzekutivit, respektivisht Kryetarit të Komunës, duke ditur se ky i fundit raporton në baza të rregullta ose kur kërkohet në Kuvendin e Komunës. Andaj, ky raport ka për qëllim informimin e qytetarëve, institucioneve relevante qeveritare dhe joqeveritare, por edhe vetë komunën, lidhur me nivelin e respektimit të ligjshmërisë nga vet komuna.

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi gjatë periudhës raportuese ka ushtruar edhe funksionin e kontrollit dhe në përmbushje të këtij funksioni, u zhvilluan dhe u shqyrtuan raportime të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive komunale, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës janë organizuar dëgjime buxhetore dhe dy takime me publikun dhe takime tjera publike për Draft Rregullore komunale dhe plane. Në përmbushje të objektivave Sekretaria e Kuvendit gjatë vitit 2025 kanë punuar për mbarëvajtjen e punës në Kuvendin e Komunës. Stafi i Sekretarisë ka mbështetur dhe ndihmuar në vazhdimësi këshilltarët për plotësimin e detyrimeve të përcaktuar nga Ligji për Statusin e anëtarit të Kuvendit dhe Rregulloren e Kuvendit. Gjithashtu ka punuar në drejtim të plotësimit dhe përmirësimeve në strukturën administrative, ka punuar për koordinimin e punës në drejtim të hartimit të akteve të nxjerra nga Kuvendi dhe të hartimit të një buxheti sa më real dhe të zbatueshëm.

Gjatë kësaj periudhe, puna e Zyrës së Teknologjisë Informative (IT) ka qenë e angazhuar në vazhdimësi në mirëmbajtjen e sistemeve informative, si: rrjeti, sistemi audio, votimit elektronik, sigurimi i pajisjeve gjatë zhvillimit të aktiviteteve brenda ambienteve të Kuvendit, kompjuterët, printerët, skanerët, fax-ët, faqja e internetit, serveri, e-mail-i, akses kontrolli. Zyra për informim ka pasqyruar në faqen e internetit në kohë reale informacionin për aktivitetin tërësor të Kuvendit të Komunës. Janë mundësuar mënyra të komunikimit dhe të kontakteve efikase me mediat, duke siguruar nëpërmjet tyre një komunikim më të shpejtë dhe me një impakt të menjëhershëm.

Sa i përket menaxhimit të buxhetit të Zyrës së Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit, në rolin e koordinatorit të këtij procesi ka përpiluar dokumentin e Programit buxhetor të Zyrës së Kuvendit për vitin 2025. Buxheti i Kuvendit është i ndarë dhe përfshinë të gjitha shërbimet që i nevojiten organit si një i tërë.

Kuvendi i komunës (Zyra e Kuvendit) ka pasur në buxhetin e zyrës të miratuar për vitin 2025 në shumë prej 247,700.00 €, sipas kategorive buxhetore si në vijim:

Paga dhe mëditje 235,700.00€

Mallra dhe shërbime 12,000.00 €

Sekretaria e Kuvendit do të vijojnë të përmbushin me kompetencë dhe cilësi, në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, detyrat e parashikuara në Rregulloren e punës së Kuvendit.

Bazuar në nenin 40, paragrafi 2, pika d. të Ligjit Për vetëqeverisje lokale, nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Statutit të Komunës, ky raport i paraqitet për miratim Kuvendit të Komunës. Më poshtë po bëjmë një përmbledhje të këtij raporti duke u ndalur në disa nga aspektet më të rëndësishme të punës së Kuvendit.

KUVENDI I KOMUNËS

Kuvendi i Komunës në periudhën janar - dhjetor 2025 ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje, prej tyre:

- 1) 4 - mbledhje të rregullta,
- 2) 0 - mbledhje të jashtëzakonshme, dhe
- 3) 0 - mbledhje urgjente.
- 4) 1 - mbledhje solemne.

Tabela nr. 1 - E mbledhjeve të Kuvendit të Komunës gjatë vitit 2025.

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS

Nr.	Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhjet	solemne	Nr. i Përkrahësve	P. V. e R. b. a. l.	Rr. e g. u. o. r. e	P. v. e. n. d. i. m.	P. l. a. n. e	R. a. p. o. r. t	T. j. e. n. d. i. m.	V. e. n. d. i. m.	Pjesëmarrja në mbledhje
1.	Janar												
2.	Shkurt	1	27.02.2025		6	1		2		2	1	5	30/35
3.	Mars	1		05.03.2025									21/35
4.	Prill		28.04.2025		14	1		9	1	2	1	6	33/35
5.	Maj												
6.	Qershor	1	30.06.2025		9	1		5		2	1	7	30/35
7.	Korrik	1											
8.	Gusht												
9.	Shtator	1	11.09.2025		6	1		3		1	1	9	32/35
10.	Tetor												
11.	Nëntor												
12.	Dhjetor												
Gjithsej		5	4	0	0	1	35	4	19	7	4	27	

Kuvendi si organi më i lartë i Komunës në të cilin shqyrtohen dhe miratohen aktet ligjore që janë në kompetencë të Komunës është institucioni ku zhvillohet dialogu politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet të gjitha forcave politike për realizimin dhe ushtrimin të funksionit legjislativ dhe funksionit zgjedhës, kjo konsiston në treguesit e mëposhtëm:

Për periudhën raportuese Kuvendi i Komunës në mbledhjet e mbajtura ka shqyrtuar gjithsej 88 pika të rendit të punës, me ç'rast ka miratuar, 0 Rregullore, 0 Statut, 75 Vendime, 10 plane dhe strategji, si dhe ka shqyrtuar 13 raporte.

Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun duke përfshirë edhe mbledhjet e komiteteve.

RREGULLORET DHE VENDIMET E KUVENDIT TË KOMUNËS TË MIRATUARA GJATË VITIT 2025

Tabela nr.2:Vendimet e dt.27.02.2025 (shkurt 2025)

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 26.12.2024	27	0	0	02-060/01-0010215-1/25
2.	Vendim Për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2025	29	0	0	02-060/01-0010215-2/25
3.	Vendim Për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025	29	0	0	02-060/01-0010215-3/25
4.	Vendim Për miratimin e Raportit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024	28	0	0	02-060/01-0010215-4/25
5.	Vendim Për miratimin e Raportit financiar për periudhën janar-dhjetor 2024	20	0	0	02-060/01-0010215-5/25

Tabela nr.3:Vendimet e dt. 28.04.2025 (prill 2025)

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së 38- të rregullt të Kuvendit të Komunës dt. 27.02.2025	32	0	0	02-060/01-0021659-1/25
2.	Vendim Për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK) 2024-2032	17	0	0	02-060/01-0021659-2/25
3.	Vendim Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale “Diakonie Kosova” pa procedura konkurrimi	22	0	0	02-060/01-0021659-3/25
4.	Vendim Për miratimin e Kërkesës së Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për ndarjen e mjeteve buxhetore	22	1	0	02-060/01-0021659-4/25
5.	Vendim Për miratimin e Planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025	16	0	0	02-060/01-0021659-6/25
6.	Vendim Për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 dhe vitet paraprake në buxhetin e vitit 2025	22	1	0	02-060/01-0021659-7/25

Tabela nr.4:Vendimet e dt. 30.06.2025 (qershor 2025)

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kun	Abst	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 28.04.2025	20	0	0	02-060/01-0035824-1/25
2.	Vendim Për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028	21	0	0	02-060/01-0035824-2/25
3.	Vendim Për Ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02-060/01-0005769/22-4 dt 31.01.2022 Për formimin e Komisionit të Aksionarëve të KRM “Uniteti	21	0	0	02-060/01-0035824-3/25
4.	Vendim Për Ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02-060/01-0072093/22-2 dt. 08.08.2022 Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e për zgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-	20	0	0	02-060/01-0035824-4-5/25
5.	Vendim Për Ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02-060/01-0080100-5/24 dt.26.12.2024 Për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve në Institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese	18	0	0	02-060/01-0035824-6/25
6.	Vendim Për miratimin e Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024	19	0	0	02-060/01-0035824-7/25
7.	Vendim Për miratimin e Raportit financiar i Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën janar-mars 2025	19	0	0	02-060/01-0035824-8/25

Tabela nr.5: Vendimet e dt. 11.09.2025 (shtator 2025)

Nr.	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kun	Abst	
1.	Vendim Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 30.06.2025	24	0	1	02-060/01-0054399-1/25
2.	Vendim Për miratimin e Buxhetit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028	21	5	0	02-060/01-54399-2/25
3.	Vendim Për plotësim dhe ndryshim të vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-00216592/25, të datës 28.04.2025	18	0	1	02-060/01-0054399-3/25
4.	Vendim Për mbështetje financiare të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së	21	0	0	02-060/01-0054399-4.1/25
5.	Vendim Për mbështetje financiare të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së	21	0	0	02-060/01-0054399-4.2/25

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2025

6.	Vendim Për mbështetje financiare (subvencionim) të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së	21	0	0	02-060/01-0054399-4.3/25
7.	Vendim Për mbështetje financiare (subvencionim) të OJQ-së “Zëri i Prindërve”- Mitrovicë	21	0	0	02-060/01-0054399-4.4/25
8.	Vendim Për mbështetje financiare (subvencionim) të Shoqatës Down Syndrome Kosova- Mitrovicë	19	0	0	02-060/01-0054399-4.5/25
9.	Vendim Për miratimin e raportit financiar janar-qershor 2025	21	0	0	02-060/01-0054399-5/25

Aktet e miratuara nga Kuvendi që pas vlerësimit të ligjshmërisë nga niveli qendror janë kthyer në rishqyrtim, data e kthimit nga Ministria si dhe data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga Kuvendi gjatë vitit 2025:

Tabela nr.6: aktet e kthyer në rishqyrtim,

Nr	Emri i aktit	Data e dërgimit në Ministri	Data e kthimit të kërkesës për rishqyrtim nga MPL-ja	Data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga Kuvendi i Komunës
1.	Vendim nr. 02-060/01-0021659-2/25 dt. 28.04.2025 Për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK) 2024-2032	03.05.2025	14.08.2025	Harmonizuar 11.09.2025.

Të gjitha rregulloret dhe vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë të publikuara në ueb faqen e komunës në të dy gjuhët.

Planet dhe strategjitë e miratuara nga Kuvendi i Komunës:

Tabela nr.7: Planet e miratuara

Nr.	Emërtimi i aktit	Datë
1.	Planit i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025	28.04.2025

Mbetet për detyrë implementimi i tyre në praktikë dhe për të arritur sa më mirë këtë duhet bashkëpunimi i të gjithë hallkave (përfaqësues, ekzekutiv, komunitet).

Raportimi i Kryetarit në Kuvendin e Komunës

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raportimi para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare si administrues i financave të komunës lidhur me shpenzimet komunale, investimet kapitale, dhe shfrytëzimin e parasë publike. Bazuar në raportimet që ka paraqitur, Kryetari i Komunës e ka përmbushur obligimin për raportim në Kuvendin e Komunës brenda vitit. Forma e raportimit ka qenë me shkrim dhe ajo verbale, të cilat janë prezantuar para anëtarëve të Kuvendit. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e bashkëpunimit dhe

Raport i punës së Kuvendit të Komunës janar–dhjetor 2025

Ilogaridhënies së ekzekutivit ndaj Kuvendit të Komunës. Kryetari i Komunës dhe ekzekutivi gjatë kësaj periudhe Kuvendit të Komunës i ka proceduar këto raporte:

Tabela nr.8 Raportet e miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe raportimet tjera

Nr.	Emërtimi i aktit	data	Nr. i protokollit
1.	Raportit i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024	27.02.2025	02-060/01-0010215-4/25
2.	Raportit financiar për periudhën janar-dhjetor 2024	27.02.2025	02-060/01-0010215-5/25
3.	Vendim Për miratimin e Raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024	30.06.2025	02-060/01-0035824-7/25
4.	Vendim Për miratimin e Raportit financiar i Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën janar-mars 2025	30.06.2025	02-060/01-0035824-8/25
5.	Vendim Për miratimin e raportit financiar janar- qershor 2025	11.09.2025	02-060/01-0054399-5/25

Mbledhjet e Kuvendit kanë qenë transparente, ftesat dhe materialet për mbledhjet e Kuvendit janë dërguar në përputhje me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores së punës së Kuvendit. Përveç kësaj, materialet përcjellëse që kanë qenë në rend të ditës për diskutim në mbledhjet e Kuvendit iu kanë dërguar edhe MAPL-së si autoritet mbikëqyrës. Sekretaria e Kuvendit në afatet e parapara ligjore të gjitha rregulloret, vendimet dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës ia ka proceduar autoritetit mbikëqyrës, respektivisht Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, dhe në afate ligjore i ka publikuar aktet e miratuara në gjuhë zyrtare, ashtu siç e parasheh Rregullorja (e MAPL) Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës janë publikuar në gjuhët zyrtare në faqen elektronike të Komunës. Kjo mundëson qasjen e publikut në informacionet dhe ngjarjet e komunës, si dhe krijon mundësinë për qasje më të lehtë në dokumentet zyrtare.

Sekretaria e Kuvendit ka zbatuar me korrektësi kërkesat ligjore për njoftimet publike (si në faqen zyrtare të komunës, në media vendore, me email drejtuar OJQ-ve, Drejtorëve të komunës, Zyrën e marrëdhënieve me publikun në komunë) në zbatim të Ligjit Për Vetëqeverisjen lokale.

KOMITETET E PËRHERSHME

Si rregull, mbledhjet e komiteteve mbahen para mbledhjeve të Kuvendit. Duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin për vetëqeverisje lokale, komitetet shqyrtojnë agjendën e propozuar nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit, ofrimi i rekomandimeve, shqyrtimi i propozim akteve dhe çështjeve të tjera të cilat parashihen për t'u trajtuar në mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë kësaj periudhe ka pasur rol të rëndësishëm në adresimin dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme të cilat kanë qenë në interesin e përgjithshëm për Komunën. Komiteti për Politikë dhe Financa i ka trajtuar pikat e rendit të ditës para se të kalojnë në diskutim dhe miratim në Kuvendin e Komunës. Trajtim të veçantë Komiteti për Politikë dhe Financa ju ka kushtuar çështjeve të natyrës financiare, si: shqyrtimit të buxhetit, kornizës afatmesme buxhetore të

komunës, si dhe çështjeve të tjera në interes të përgjithshëm si: rregulloret komunale, dhënia e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë, etj.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e:

1. Të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare,
2. Planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik,
3. Kornizën vjetore buxhetore dhe afatmesme,
4. Planin vjetor të prokurimit,
5. Rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat,
6. Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm,
7. Buxhetin vjetor dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal,
8. Për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvend, si dhe
9. Monitorimin e bashkëpunimit, ndër komunal, me nivelin qendror dhe me jashtë.

Kuvendi mund t'i delegojë edhe përgjegjësi tjera nga fushëveprimi i tij Komitetit për Politikë dhe Financa.

Komiteti për Politikë dhe Financa për periudhën raportuese ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, prej të cilave 9 mbledhje të rregullta, 1 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 1 mbledhje urgjente

Komiteti ka shqyrtuar 88 pika të rendit të punës, i janë propozuar Kuvendit të Komunës 10 Draft-Rregullore, 8 plane, ka sjellë mbi 35 konkluzione dhe 25 raporte, të cilat ia ka proceduar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Tabela nr.9 mbledhjet e KPF-së

Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa												
Nr.	Muaji	Nr. mbledhjeve	Të rregullta	Tw Jashtz	Data	Nr pikave	P. ver bal	rregullo re	P vend im	Pl an e	Rap orte	TjeraPjesëma rrja
1.	Janar	1	1		31.01.2025	4	1		2		1	9/9
2.	Shkurt	1	1		26.02.2025	2	1				1	8/9
3.	Mars	1	1		28.03.2025	4	1				1	8/9
4.	Prill	2		1	04.04.2025	1			1			8/9
			1		25.04.2025	6	2		2	1	1	8/9
5.	Maj	1	1		30.05.2025	2	1					8/9
6.	Qershor	1	1		19.06.2025	2	1		1			8/9
7.	Korrik	1	1		25.07.2025	2	1				1	8/9
8.	Gusht	1		1	25.08.2025	2	1		1			8/9
9.	Shtator	1	1		10.09.2025	2	1		1			8/9
	Gjithsej	10	8	2		27	10		8	1	5	2

Komiteti për Komunitete

Komiteti për Komunitete përbehet nga anëtarët e Kuvendit dhe përfaqësuesit e komuniteteve dhe është përgjegjës për:

1. Promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim dhe bën rekomandime për Kuvendin e Komunës.
2. Shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

3. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe
4. për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

Komiteti për Komunitete për periudhën raportuese ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje të rregullta, ka shqyrtuar 27 pika të rendit të ditës, janë miratuar 12 procesverbale, janë nxjerrë, 9 rekomandime për Kryetarin e Komunës dhe Kuvendin e Komunës (shih tabelën).

Tabela nr.10 mbledhjet e Komitetit për Komunitete

Nr.	Muaji	Nr. i mbledhjeve	Mbledhjet e Komitetit për Komunitete							rekomandime	Pjesëmarrja në mbledhje
			Mbledhje të rregullta	Nr i pikave	P. verbal	p.rreg ullore	plane	raporte	tjera		
1.	Janar	1	30.01.2025	2	1				1	1	11/11
2.	Shkurt	1	27.02.2025	2	1				1	1	11/11
3.	Mars	1	25.03.2025	2	1			1		1	10/11
4.	Prill	1	30.04.2025	2	1		1			1	11/11
5.	Maj	1	23.05.2025	2	1				1	1	10/11
6.	Qershor	1	19.06.2025	2	1		1			1	11/11
7.	Korrik	1	14.07.2025	2	1				1	1	10/11
8.	Gusht	1	26.08.2025	2	1			1		1	11/11
9.	Shtator	1	10.09.2025	2	1			1		1	11/11
10.	Gjithsej	9		18	9		2	3	4	9	

Komitetet funksionale

Kuvendi i Komunës për kryerjen e përgjegjësi në sektor të caktuar me vendim ka themeluar Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komitetin për Barazi Gjinore, Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Komiteti për Zhvillim Ekonomik. Komitetet funksionale kanë mbajtur mbledhjet si në vijim:

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - 0 mbledhje.

Komiteti për Barazi Gjinore - 0 mbledhje.

Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Pronë dhe Mbrojtje të Ambientit - 0 mbledhje.

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - 0 mbledhje.

Komiteti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim - ka mbajtur 1 mbledhje.

Komiteti për Zhvillim Ekonomik - 0 mbledhje.

Komitetet konsultative

Komitetet konsultative janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, roli i të cilave është që përmes këtyre komiteve të garantohet që organet e komunës të jenë më transparente më efikase dhe ti japin më shumë llogari qytetarëve, si dhe të krijoj mundësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Komitetet konsultative kanë mbajtur mbledhjet si në vijim:

- Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport – 0 mbledhje
- Komiteti Konsultativ për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Persona me Afësi të Kulëzuara – 0 mbledhje

- Komiteti Konsultativ për Shërbime Publike, Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje Të Mjedisit – 0 mbledhje.

Komisionet e Aksionarëve

Komuna si aksionare e ndërmarrjeve publike lokale, të drejtat si aksionar i ushtron përmes Komisioneve Komunale të Aksionarëve. Komisionet Komunale të Aksionarëve veprojnë në emër të Komunës dhe në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare. Komisionet Komunale të Aksionarëve kanë mbajtur mbledhjet si në vijim:

- Komisioni i aksionarëve të N.P “Qendra Multifunkionale” - ka mbajtur 1 mbledhje.
- Komisioni i aksionarëve të N.P “Stacioni i Autobusëve ” - ka mbajtur 0 mbledhje.
- Komisioni i aksionarëve të N.P “Tregu” - ka mbajtur 0 mbledhje.
- Komisioni i aksionarëve të K.R.M. “Uniteti” - ka mbajtur 6 mbledhje.

Në vitin 2025 Kuvendi ka synuar të forcojë më tej rolin e tij në ushtrim të funksionit kushtetues legjislativ dhe të kontrollit. Me rëndësi të veçantë dhe për t’u vënë në dukje është edhe puna e madhe që u bë nga Kuvendi për miratimin e buxhetit të Komunës për vitin 2025.

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi gjatë vitit 2025 ka ushtruar edhe funksionin e kontrollit politik ndaj ekzekutivit si dhe ka monitoruar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjet dhe aktet tjera nënligjore, Statutin e Komunës, dhe vendimeve të Kuvendit të Komunës, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit të parashikuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statut dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit. Në ushtrim të kontrollit parlamentar u zhvilluan 14 raporte të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive, për të cilat anëtarët e Kuvendit kanë zhvilluar debat dhe kanë marrë përgjigjet për problemet e ngritura.

Objektivat e Kuvendit për vitin 2025

Për vitin 2025 Kuvendi synon të forcojë më tej rolin e tij në ushtrim të funksionit ligjor legjislativ dhe të kontrollit, të forcojë më tej rolin e tij shqyrtues, duke përfshirë shoqërinë civile dhe grupet e interesit në procesin legjislativ, të rrisë dialogun politik mes pozitës dhe opozitës, me qëllim forcimin e funksionimit të tij demokratik, të rrisë më tej transparencën për informimin e publikut me dokumentacionin e nxjerr nga Kuvendi, të forcojë më tej kapacitetet e tij administrative në përgjithësi.

Përfundime

Kuvendi i Komunës, komitetet e përhershme të kuvendit, gjatë vitit 2025 ka mbajtur 5 mbledhje.

Ftesat, materialet e mbledhjes dhe njoftimet për mbledhje janë respektuar afatet ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit;

Ka funksionuar sistemi i teleprezencës me qëllim të monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Gjithashtu mbledhjet janë monitoruar edhe përmes pranisë fizike të monitoruesve;

Të gjitha mbledhjet kanë qenë të hapura për publikun;

Gjatë mbledhjeve në tërësi është respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe është bërë përkthimi i vendimeve në gjuhët zyrtare;

Janë mbajtur takime publike me qytetarë, - diskutimet buxhetore, etj;

Është miratuar Buxheti i Komunës;

Kryetari i Komunës ka raportuar para Kuvendit të Komunës sipas nenit 58, pika (j);

Aktet e miratuara në Kuvendin e Komunës janë publikuar në faqet zyrtare elektronike në gjuhët zyrtare;

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme për të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave për të komunikuar me publikun për çështje si diskutimi për buxhetin e komunës, këmbimit dhe dhënies në shfrytëzim të pronave, miratimi i rregulloreve etj, me qëllim pjesëmarrjen aktive në vendimmarrje të qytetarit. Del si detyrë që çdo anëtar i Kuvendit të Komunës për aktet normative të cilat do të diskutohen dhe vendosen në kuvend, të marrë opinionet dhe vërejtjet e publike në lagjen ose fshatin që ata përfaqësojnë para se të gjykohet apo shqyrtohet për të.

Punë të mbarë për vitin 2026 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

Falënderimet gjithashtu shkojnë për:

- 1. Administratën e Komunës për punën e palodhur dhe mbështetjen që i kanë dhënë Sekretarisë së Kuvendit.*
- 2. Kabinetin e Kryetarit, Drejtoritë e komunës, zyrën e IT, Zyrën për informim dhe Zyrën për Shërbime me Qytetarë.*